



01 Nr. 692/24 Dt. 05.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, konform kërkesës (raportit) të Menaxherit të Kontratës, për lejimin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Ndërtimi i tualeteve publike në qytetin e Prizrenit”-projekt dy vjeçar, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti, lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 4364 € (katërmijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër euro).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t’i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-24-1447-5-2-1 nga OE “MBB Konstruktion” Shpk.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nr. 52118.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

